



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit*  
*Ministarstvo za Saobraćaj Postu i Telekomunikacije*  
*Ministry of Transport and Communications*

---

**RREGULLORJA Nr. 2008/5**  
**MBI KRIJIMIN E RREGULLAVE TË PËRGJITHSHME PËR KOMPENSIMIN**  
**DHE ASISTIMIN E UDHËTARËVE NË RAST TË NDALIMIT TË HIPJES DHE**  
**TË ANULIMIT APO VONESAVE TË GJATA TË FLUTURIMEVE**

**Ministri,**

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 4 (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 01/2007,

Në pajtim me Nenin 6.1 të Ligjit mbi Aviacionin Civil (Ligji Nr. 03/L-051) të datës 13 Mars 2008,

Duke pasur parasysh nënshkrimin nga ana e UNMIK-ut të Marrëveshjes Multilaterale mbi Krijimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (“Marrëveshja HPEA”) në emër të Kosovës dhe hyrjes së përkohshme në fuqi të Marrëveshjes së HPEA-së në Kosovë më datën 10 Tetor 2006,

Me qëllim të përcaktimit të rregullave për kompensimin dhe asistimin e udhëtarëve në rast se u ndalohet hipja dhe anulimit ose vonesave të gjata të fluturimeve në pajtim me Marrëveshje e HPEA-së dhe kërkesës që Rregullorja (EC) Nr 261/2004 të bëhet pjesë e rregullave të brendshme ligjore të Kosovës

Me anë të kësaj lëshon Rregulloren në vijim:

**Neni 1**  
**Lënda**

1. Kjo Rregullore përcakton, sipas kushteve të specifikuara këtu, të drejta minimale të udhëtarëve kur:

- (a) atyre u ndalohe hipja kundër dëshirës së tyre;
- (b) fluturimi i tyre është anuluar;
- (c) fluturimi i tyre është vonuar.

## **Neni 2**

### **Përkufizimet**

Në këtë Rregullore:

“transportues ajror” do të thotë ndërmarrës i transportit ajror me licencë valide për operim;

“transportues ajror operativ” do të thotë transportuesi ajror, i cili realizon apo synon të realizojë një fluturim sipas kontratës me udhëtarin apo në emër të personit tjetër, goftë ai person juridik apo fizik, i cili ka kontratë me atë udhëtarë;

“Marrëveshja HPEA” do të thotë Marrëveshja Multilaterale në mes të Komunitetit Evropian dhe Shteteve Anëtare të saj, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë mbi Krijimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit;

“transportues ajror i HPEA-së” do të thotë një transportues ajror i cili është i licencuar si kërkohet nga Marrëveshja e HPEA-së në pajtim me dispozitat e Rregullores (EEC) Nr 2407/92, të specifikuar në Shtojcën i të Marrëveshjes HPEA-së;

“Operator i udhëtimit” do të thotë, me përjashtim të transportuesit ajror, organizatori në kuptimin e Nenit 2, pika 2 të Urdhëresës së Këshillit 90/314/EEC të datës 13 Qershor 1990 për udhëtime në paketë, pushime në paketë dhe turne në paketë;

“paketë” do të thotë ato shërbime të përkufizuara në Nenin 2, pika 1 të Urdhëresës 90/314/EEC;

“Biletë” do të thotë dokumenti i vlefshëm me të cilin lejohet transporti apo diçka tjetër ekuivalent jo në letër, duke përfshirë edhe formën elektronike, por i lëshuar ose i autorizuar nga transportuesi ajror apo agjenti i tij i autorizuar;

“Rezervim” do të thotë fakti se udhëtari ka biletë apo dëshmi tjetër me të cilën tregohet se rezervimi është pranuar dhe është regjistruar nga transportuesi ajror ose operatori i udhëtimeve

“Destinim përfundimtar” do të thotë destinimi i paraqitur në sportelin e regjistrimit ose destinimi i fluturimit të fundit në rastin e fluturimit të bashkuar drejtpërdrejt; fluturimet e bashkuara alternative që janë në dispozicion nuk merren parasysh nëse respektohet afati i parë i planifikuar kohor për arritje;

“Person me lëvizshmëri të zvogëluar” do të thotë çdo person lëvizshmëria e të cilit është e zvogëluar kur e shfrytëzon transportin për shkak të paaftësisë fizike (ndijimore ose lëvizore, të përhershme apo të përkohshme), paaftësisë mendore, moshës apo ndonjë shkak tjetër të paaftësisë dhe gjendja e të cilit kërkon vëmendje të posaçme dhe përshtatje me nevojat e personit për shërbimet që u ofrohen të gjithë udhëtarëve;

“Hipje e ndaluar” do të thotë refuzimi për të bartur udhëtarë në fluturim edhe pse janë paraqitur për fluturim sipas kushteve të parashtruara në nenin 3(2), përveç rasteve kur ka arsye të bazuar për t’iu ndaluar hipjen, siç janë arsyet shëndetësore, të mbrojtjes ose sigurisë apo dokumentet joadekuate të udhëtimit;

“Vullnetar” do të thotë personi, i cili është paraqitur për hipje sipas kushteve të parashtruara në nenin 3(2) dhe pozitivisht i përgjigjet thirrjes së transportuesit ajror për udhëtarë që janë të përgatitur të dorëzojnë rezervimin e tyre në këmbim të ndonjë përfitimi tjetër;

“Anulim” do të thotë mosrealizim i fluturimit të planifikuar paraprakisht dhe në të cilin është rezervuar së paku një vend;

“Ministria” do të thotë Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit të Republikës së Kosovës;

“UNMIK” do të thotë Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë.

“Komision” do të thotë Komisioni Evropian.

“Këshill” do të thotë Këshilli Evropian.

### **Neni 3 Fushëveprimi**

1. Kjo Rregullore zbatohet:

(a) për udhëtarët që nisen nga një aeroport i vendosur në territorin e Kosovës;

(b) për udhëtarët që nisen nga një aeroport i vendosur në një vend të tretë në një aeroport që gjendet në territorin e Kosovës, përveç nëse ata kanë pranuar përfitimet apo kompensimin dhe u është dhënë asistencë në atë vend të tretë, nëse

transportuesi ajror operativë i fluturimit në fjalë është transportues ajror i HPEA-së.

2. Paragrafi 1 zbatohet me kusht që udhëtarët:

(a) kanë rezervim të konfirmuar të fluturimit në fjalë dhe, përveç rastit të anulimit të cilit iu referuam në nenin 5, paraqiten për regjistrim:

- ashtu siç është paraparë dhe në kohën a caktuar paraprakisht me shkrim (përfshirë edhe mjetet elektronike) nga transportuesi ajror, nga operatori i udhëtimit ose agjenti i autorizuar i udhëtimit, ose, nëse nuk është caktuar koha,
- jo më vonë se 45 minuta para kohës së publikuar të nisjes; ose

(b) janë transferuar nga transportuesi ajror apo operatori i udhëtimit nga një fluturim për të cilin kanë pasur rezervim, në tjetrin pavarësisht nga arsyeja

3. Kjo Rregullore nuk zbatohet për udhëtarë të cilët udhëtojnë falas ose me pagesë mjaft të zvogëluar për të cilën opinioni publik nuk është në dijeni as në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe as të tërthortë. Megjithatë, kjo zbatohet për udhëtarë të cilët kanë bileta të lëshuara përmes programeve për fluturime të rregullta ose përmes programeve të tjera komerciale të transportuesve ajrorë a operatorëve të udhëtimeve
4. Kjo Rregullore zbatohet vetëm për udhëtarët që transportohen me aeroplan të motorizuar me krahë të fiksuar
5. Kjo Rregullore zbatohet për çdo transportues ajror operativ, që ofron transport për udhëtarët nga paragrafi 1 dhe 2. Kur transportuesi ajror operativ, i cili nuk ka kontratë me udhëtarin kryen obligimet sipas kësaj Rregullore, konsiderohet se këtë e bën në emër të personit që ka kontratë me atë udhëtarë.
6. Kjo Rregullore nuk ndikon të drejtën e udhëtarëve sipas Urdhëresës 90/314/EEC. Kjo Rregullore nuk zbatohet në rastet kur udhëtimi në paketë anulohet për arsye të tjera përveç anulimit të fluturimit

#### **Neni 4 Hipja e ndaluar**

1. Kur transportuesi ajror operativ me arsye pret që të ndalojë hipjen në atë fluturim, së pari duhet të thirrë vullnetarë për të dorëzuar rezervimin e tyre në këmbim të përfitimit tjetër sipas kushteve për të cilat do të arrihet marrëveshje ndërmjet udhëtarit në fjalë dhe transportuesit ajror operativ. Vullnetarët do të ndihmohen në pajtim me nenin 8 dhe ndihma e tillë konsiderohet shtesë e përfitimit të përmendur në këtë paragraf.
2. Nëse një numër i pamjaftueshëm i udhëtarëve paraqiten vullnetar për të dorëzuar rezervimin e tyre për të lejuar numrin adekuat të udhëtarëve me rezervime që të

hipin në aeroplan, transportuesi ajror operativ ndalon hipjen e udhëtarëve me rezervime kundër vullnetit të tyre

3. Nëse hipja u ndalohet udhëtarëve kundër vullnetit të tyre, transportuesi ajror operativ i kompenson ato menjëherë në pajtim me nenin 7 dhe i ndihmon ata në pajtim me nenin 8 dhe 9.

## **Neni 5 Anulimi**

1. Në rast të anulimit të fluturimit, udhëtarëve në fjalë:
  - (a) u ofrohet ndihmë nga transportuesi ajror operativ në pajtim me nenin 8; dhe
  - (b) u ofrohet ndihmë nga transportuesi ajror operativ në pajtim me nenin 9.1 (a) dhe nenin 9.2, si dhe në rastin e ndryshimit të itinerarit kur koha e pritur me arsye e nisjes së fluturimit të ri është së paku një ditë pas nisjes së paraparë për fluturimin e anuluar u ofrohet ndihma e përcaktuar në nenin 9.1 (b) dhe 9.1(c) dhe
  - (c) kanë të drejtë në kompensim nga transportuesi ajror operativ në pajtim me nenin 7 përveç nëse:
    - (i) ata janë njoftuar për anulimin së paku dy javë përpara kohës së paraparë për nisje ose
    - (ii) ata janë njoftuar për anulimin në kohën ndërmjet dy javëve dhe shtatë ditëve para kohës së paraparë për nisje dhe u është ofruar linjë tjetër, duke iu mundësuar atyre nisjen jo më vonë se dy orë para kohës së paraparë për nisje dhe arritjen në destinacionin e fundit për më pak se katër orë pas kohës së paraparë për arritje, ose
    - (iii) ata janë njoftuar për anulimin më pak se shtatë ditë para kohës së paraparë për nisje dhe u është ofruar linjë tjetër, duke iu mundësuar që të nisen jo më vonë se një orë para kohës së paraparë për nisje dhe që të arrijnë te destinacioni i tyre i fundit më pak se dy orë pas kohës së paraparë për arritje
2. Kur udhëtarët njoftohen për anulimin, atyre u jipen sqarime lidhur me mundësitë alternative të transportit.
3. Transportuesi ajror operativ nuk obligohet që të paguajë kompensim në pajtim me nenin 7 nëse mund të vërtetohet se anulimi është shkaktuar nga rrethanat e jashtëzakonshme të cilave nuk kanë mundur t'iu shmangen edhe po të ishin marrë të gjitha masat e arsyeshme

4. Barrën e dëshmisë përkitazi me çështjen nëse udhëtari është informuar për anulimin e fluturimit dhe kur e bart transportuesi ajror operativ

## **Neni 6 Vonesa**

1. Kur transportuesi ajror operativ me arsye pret vonesë të fluturimit që tejkalon orarin e paraparë të nisjes:
  - (a) për dy apo më shumë orë në rastin e fluturimeve prej 1 500 kilometrave ose më pak; ose
  - (b) për tri orë apo më tepër në rastin e të gjitha ndër-HPEA-së fluturimeve mbi 1 500 kilometrave dhe për të gjitha fluturimet tjera ndërmejt 1.500 kilometrave dhe 3 500 kilometrave; ose
  - (c) për katër orë a më tepër në rastin e të gjitha fluturimeve, të cilët nuk bien nën (a) dhe (b), transportuesi ajror operativ u ofron udhëtarëve:
    - (i) ndihmën e përcaktuar në nenin 9.1 (a) dhe 9.2; dhe
    - (ii) kur koha e arsyeshme e pritur e nisjes është së paku një ditë pas kohës së nisjes të shpallur paraprakisht, u ofrohet ndihma e përcaktuar në nenin 9.1 (b) dhe 9.1 (c) dhe
    - (iii) kur vonesa është së paku pesë orë, u ofrohet ndihma e përcaktuar në nenin 8.1
- (a).
2. Në çdo rast ndihma ofrohet në kuadër të afateve kohore të përcaktuara më lart lidhur me çdo interval kohor.

## **Neni 7 E drejta në kompensim**

1. Çdo herë kur i referohemi këtij neni, udhëtarët kompensohen me një shumë prej:
    - (a) €250 për të gjitha fluturimet prej 1.500 kilometra ose më pak;
    - (b) 400 Euro për të gjitha fluturimet ndër-HPEA-së prej më shumë se 1500 kilometra dhe për të gjitha fluturimet ndërmjet 1 500 kilometra dhe 3 500 kilometra;
    - (c) 600 Euro për të gjitha fluturimet që nuk bien nën (a) ose (b).
- Gjatë përcaktimit të intervalit kohor, për bazë merret destinacioni i fundit ku ndalimi i hipjes ose anulimi e ka vonuar arritjen e udhëtarit pas kohës së paraparë.

2. Kur udhëtarëve u ofrohet linjë tjetër për të arritur në destinacionin e tyre të fundit me një fluturim alternativ në pajtim me nenin 8, koha e arritjes së të cilit nuk kalon kohën e paraparë për arritje të fluturimit të rezervuar fillimisht
  - (a) për dy orë për të gjitha fluturimet prej 1 500 kilometra ose më pak; ose
  - (b) për tri orë për të gjitha fluturimet ndër-HPEA-së prej më shumë se 1 500 kilometra dhe për të gjitha fluturimet ndërmjet 1 500 kilometrave dhe 3 500 kilometra; ose
  - (c) për katër (4) orë për të gjitha fluturimet që nuk bien nën (a) ose (b), transportuesi ajror operativ mund të zvogëlojë kompensimin e paraparë në paragrafin 1 për 50 %.
3. Kompensimi i referuar në paragrafin 1 do të paguhet me para të gatshme, me transfer elektronik bankar, me urdhra bankare a çeqe të bankës ose, me marrëveshje të nënshkruar nga udhëtari, me dëshmi të udhëtimit dhe/apo përmes shërbimeve të tjera.
4. Intervali i dhënë në paragrafët 1 dhe 2 maten me metodën e rrethit të madh për caktimin e distancës

### **Neni 8**

#### **E drejta në rimbursim ose për linjë të re**

1. Kur i referohemi këtij neni, udhëtarëve u ofrohet zgjidhje ndërmejt:
  - pagesës brenda shtatë (7) ditësh përmes mënyrave të caktuara në nenin 7.3 të vlerës së plotë të biletës me çmimin që është blerë për pjesën apo pjesët e përcaktuara të udhëtimit dhe për pjesën apo pjesët e realizuara nëse fluturimi nuk i shërben asnjë qëllimi të planit për udhëtim të udhëtarit së bashku me, nëse kjo është relevante,
    - një fluturim për t'u kthyer në pikën e parë të nisjes, sa më parë që t'i jipet mundësia;
    - (b) linjës tjetër sipas kushteve të krahasueshme të transportit për në destinacionin e fundit sa më parë që t'i jipet mundësia ose
    - or
    - (c) linjës tjetër sipas kushteve të krahasueshme të transportit për në destinacionin e fundit, në një datë të mëvonshme kur i përshtatet udhëtarit, nëse ka ulëse.
2. Paragrafi 1 (a) gjithashtu zbatohet për udhëtarë fluturimi i të cilëve përbën pjesë të udhëtimit në paketë, përveç të drejtës për rimbursim (pagesë) ku kjo e drejtë del në pajtim me Urdhëresën 90/314/EEC.

3. Në rastin kur një qytezë, qytet apo rajon është në shërbim të disa aeroporteve, kur transportuesi ajror operativë i ofron udhëtarit fluturim në aeroportin alternativë për në atë për të cilin ka bërë rezervimin, transportuesi ajror operativë mbulon koston e transferimit të udhëtarit nga ai aeroport alternativë qoftë për në atë për të cilin ka bërë rezervimin, apo në një tjetër afër destinimit sipas marrëveshjes me udhëtarin.

### **Article 9** **E drejta në përkujdesje**

1. Kur i referohemi këtij neni udhëtarëve u ofrohen falas:
  - (a) shujta dhe pijet freskuese në relacion të arsyeshëm me kohën e pritjes;
  - (b) vendosje në hotel në rastet kur:
    - pritja për një apo më shumë net është e domosdoshme ose
    - qëndrimi, që është i domosdoshëm, përveç atij të paraparë nga udhëtari;
  - (c) transporti prej aeroportit te vendakomodimi (në hotel apo diku tjetër).
2. Përveç kësaj, udhëtarëve u ofrohen falas dy thirrje telefonike, telex apo fax-porosi ose posta elektronike.
3. Gjatë zbatimit të këtij neni, transportuesi ajror operativ u kushton rendësi të posaçme nevojave të personave me lëvizshmëri të zvogëluar dhe personave që i shoqërojnë ata, si dhe nevojave të fëmijëve të pashoqëruar.

### **Neni 10** **Vendosja në klasë më lartë dhe më të ulët**

1. Nëse transportuesi ajror operativ e vendos udhëtarin në një klasë më të lartë se ajo për të cilën është blerë bileta nuk kërkon pagesë shtesë.
2. Nëse transportuesi ajror operativ e vendos udhëtarin në një klasë më të ulët se ajo për të cilën është blerë bileta brenda shtatë ditëve përmes mënyrave të parapara në nenin 7 (3) i paguan:
  - (a) 30% të çmimit të biletës për të gjitha fluturimet prej 1 500 kilometra ose më pak, ose;
  - (b) 50% të çmimit të biletës për të gjitha fluturimet ndër-HPEA-së prej më shumë se 1 500 kilometra, përveç fluturimeve ndërmjet territorit të Kosovës dhe



departamenteve franceze jashtë saj dhe për të gjitha fluturimet ndërmjet 1 500 kilometra dhe 3 500 kilometra, ose

(c) 75% të çmimit të biletës për të gjitha fluturimet që nuk bien nën (a) ose (b), përfshirë fluturimet ndërmjet territorit të Kosovës dhe departamenteve franceze jashtë saj.

### **Neni 11**

#### **Personat me lëvizshmëri të zvogëluar apo me nevoja të veçanta**

1. Transportuesit ajrorë operativë i japin përparësi bartjes së personave me lëvizshmëri të kufizuar dhe personave apo qenve të certifikuar për shërbim që i shoqërojnë ata, si dhe fëmijëve pa shoqërues.
2. Në rastet e hipjes së ndaluar, anulimit dhe vonesave të çfarëdo kohëzgjatjeje, personat me lëvizshmëri të zvogëluar dhe çdo person që i shoqëron ata, si dhe fëmijët pa shoqërues kanë të drejtë në përkujdesje sipas nenit 9 sa më shpejt që të jetë e mundur.

### **Neni 12**

#### **Kompensimi i mëtutjeshëm**

1. Kjo Rregullore zbatohet pa cenuar të drejtën e udhëtarit në kompensim të mëtutjeshëm. Kompensimi i dhënë sipas kësaj Rregullore mund të hiqet nga kompensimi i tillë.
2. Pa përjashtuar parimet dhe rregullat përkatëse të ligjit të aplikueshëm në Kosovë, paragrafi 1 nuk vlen për udhëtarët, të cilët vullnetarisht e kanë dorëzuar rezervimin sipas nenit 4.1.

### **Neni 13**

#### **E drejta e kompensimit**

Në rastin kur një transportues ajror operativ paguan kompensim apo përmbush obligimet tjera për të cilat është i detyruar, sipas kësaj Rregullore asnjë dispozitë e kësaj Rregullore nuk mund të interpretohet si kufizim i të drejtës së tij për të kërkuar kompensim nga cilido person, përfshirë edhe palën e tretë, në pajtim me ligjin në fuqi. Në veçanti, kjo Rregullore në asnjë mënyrë nuk do të kufizojë të drejtën e transportuesit ajror operativ për të kërkuar kompensim material nga operatori i udhëtimit apo nga ndonjë person tjetër me të cilin transportuesi ajror operativ ka kontratë. Ngjashëm me këtë, asnjë dispozitë e kësaj Rregullore nuk do të mund të interpretohet si kufizim i të drejtës së operatorit të udhëtimit apo palës së tretë që të kërkojë kompensim material apo kompensim nga transportuesi ajror operativ në pajtim me ligjet përkatëse në fuqi përveç udhëtarit me të cilin transportuesi ajror operativ ka kontratë.

## **Neni 14**

### **Obligimi i informimit të udhëtarëve për të drejtat e tyre**

1. Transportuesi ajror operativ do të sigurojë që në sportelet e regjistrimit të vendosen lajmërimi të lexueshme dhe të qarta në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze me tekstin në vijim të paraqitur në mënyrë të qartë dhe të dukshme për udhëtarët: “Nëse ju ndalohet hipja në aeroplan apo nëse fluturimi juaj është anuluar apo vonuar për të paktën dy orë, kërkoje në sportelin e regjistrimit a në portën e hyrjes në aeroplan tekstin ku ceken të drejtat tuaja, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me kompensimin dhe ndihmën”.
2. Transportuesi ajror operativ që ndalon hipjen në aeroplan apo që anulon fluturimin, çdo udhëtar i të prekur nga kjo i ofron njoftim të shkruar që përcakton rregullat për kompensim dhe ndihmën në përputhje me këtë Rregullore. Njoftim i ngjashëm po ashtu i ofrohet çdo udhëtar i të prekur nga vonesa së paku dyorëshe. Udhëtarit i jepen në formë të shkruar edhe detajet për të kontaktuar Ministrinë e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit të Republikës së Kosovës.
3. Për personat e verbër dhe për ata me dëmtime në të parë zbatohen dispozitat e këtij neni duke përdorur mjetet e duhura alternative.

## **Neni 15**

### **Përgjegjësi i heqjes dorë**

1. Obligimet ndaj udhëtarëve në pajtim me këtë Rregullore nuk mund të kufizohen apo hiqen veçanërisht me ndonjë nen për ulje apo kufizim në kontratën e transportimit.
- 15.2 Sidoqoftë, nëse zbatohet ndonjë nen për ulje a kufizim që ka të bëjë me udhëtarin, apo nëse udhëtarin nuk është informuar saktësisht mbi të drejtat e tij dhe për këtë arsye e ka pranuar kompensimin që është më i ulët se ai i paraparë në këtë Rregullore, udhëtarin prapë ka të drejtë të iniciojë procedurat e nevojshme në gjykatat apo organet kompetente për të marrë kompensimin shtesë.

## **Neni 16**

### **Shkeljet**

1. Divizioni i Aviacionit Civil i Ministrisë së Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit është organi përgjegjës për zbatimin e kësaj Rregullore lidhur me fluturimet nga aeroportet e Kosovës. Aty ku duhet Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit do të ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar respektimin e të drejtave të udhëtarëve. Qeveria e Republikës së Kosovës informon Komisionin se Divizioni i Aviacionit Civil i Ministrisë së Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit është organi përgjegjës për zbatimin e kësaj Rregullore për fluturimet nga aeroportet në territorin e Kosovës dhe për fluturimet nga vendet e treta në këto aeroporte.

2. Pa paragjykuar nenin 12, çdo udhëtarë mund të ankohet në Divizionin e Aviacionit Civil të Ministrisë së Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit për ndonjë shkelje të supozuar të kësaj Rregullore në cilindo aeroport në territorin e Kosovës, ose që ka të bëjë me cilindo fluturim nga vendet e treta në një aeroport në territorin e Kosovës
3. Ministria do të vendos sanksionet në pajtim me Nenin 97.2 të Ligjit mbi Aviacionin Civil (Ligji Nr. 03/L-051) për shkeljen e kësaj Rregullore.

### **Neni 17 Raportimi**

Komisioni i raporton Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi funksionimin dhe rezultatet e kësaj Rregullore, e në veçanti lidhur me:

- incidentet e ndalimit të hipjes dhe anulimit të fluturimeve,
- zgjerimin e mundshëm të fushës së veprimit të kësaj Rregullore dhe Rregullores (EC) Nr 261/2004 për udhëtarët që kanë kontratë me transportues ajror të HPEA-së ose kanë rezervimin e fluturimit që është pjesë e ‘paketës së udhëtimit’ mbi të cilën zbatohet Urdhëresa 90/314/EEC dhe i cili nisët nga një aeroport prej vendi të tretë për në një aeroport të Palës Kontraktuese së HPEA-së, për fluturimet që nuk operohen nga transportues ajror të HPEA-së,
- rishikimin e mundshëm të shumave për kompensim që i referohemi Nenit 7.1.

Raporti përcjellet me propozime për legjislacion ku është e nevojshme.

### **Neni 18 Anulimi**

Kjo Rregullore anulon Urdhëresën Administrative 2005/14 të UNMIK-ut.

### **Neni 19 Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi më datën 20/Nëntor/2008.

Datë:03/Nëntor/2008

Fatmir Limaj

Ministër i Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit